



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 2867/12 .Prot

Datë 27.07 2023

VENDIM

NR. 69 , DATË 26.07 .2023

**“PËR DHËNIE NDIHMË FINANCIARE PËR PUNONJËSIN Z. ALBERT SHEGANI”**

Në mbështetje të nenit 8, pikes 1.3.a të nenit 9, të shkronjës “dh” të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikës 132 të udhëzimit nr. 9 , date 20.03.2018 “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.144, datë 28.12.2022, “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2023”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Dhënien e ndihmës financiare në masën 300.000 (treqind mijë lekë) për arsye se Z. Albert Shegani ndodhet në kushte të vështira ekonomike dhe në gjendje të rënduar shëndetësore .
2. Ky fond përballohet nga fondi rezerve i parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Pogradec për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.
4. Vendimi të hyjë në fuqi menjëherë mbas lajmërimit të subjektit/individit.

**KRYETARË E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**



<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [keshilibashkiakpogradec@gmail.com](mailto:keshilibashkiakpogradec@gmail.com)